REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI MBIKQYRES
DREJTORIA E UJESJELLES KANALIZIME SH.A POGRADEC

VENDIM

"Emerimin e e Drejtorit te Pergjithshem te UK sh.a Pogradec"

NR. 14 DATE 22.05.2013

Keshilli Mbikqyres i UK sh.a Pogradec i mbledhur sot me date 22.05.2013 ora 11:00 ne godinen administrative te UK sh.a Pogradec ne zbatim te ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008, "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" dhe VKM 678 dt. 03.10.2007 Statutit te Ujesjelles Kanalizime sh.a Pogradec referuar lajmerimit te bere nga Drejtuesi i Keshillit Mbikqyres per mbledhje ne Nr. 121/1 Prot. date 17.05.2013.

VENDOSI

Emerimin me unanimitet te Drejtorit te Pergjithshem te UK sh.a Pogradec **Z. ERJON VESHO** me page mujore bruto 110 000 lek (njeqind e dhjete mije lek)

Keshilli Mbikqyres

Z. Erjon Vesho **Kryetar i Keshillit** Nuk mora pjesë në votim
Z. Roshi Tollozhina **N/kryetar i keshillit**
Z. Gentjan Mahmutaj **Antar i keshillit**
Znj. Mimoza Shuli **Antare e Keshillit**
Z. Petro Stefani **Antar i keshillit**
Z. Thoma Angjellari **Antar i keshillit**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ASAMBLEJA E AKSIONAREVE
DREJTORIA E UJESJELLES KANALIZIME SH.A POGRADEC

VENDIM

"Miratimi i dorheqjes se kryetarit te Keshillit Mbikqyres"

NR. 6 DATE 29.05.2013

Asambleja e Aksionareve te UK sh.a Pogradec e mbledhur sot me date 29.05.2013 ora 11:00 ne godinen administrative te UK sh.a Pogradec ne zbatim te ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008, "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" referuar kerkeses Nr.134/1Prot. date 27.05.2013 se drejtorit te pergjithshem per mbledhje te Asamblese se Aksionareve si dhe referuar kerkeses per dorheqje te Kryetarit te Keshillit Mbikqyres Z. Erjon Vesho ne date 22.05.2013.

VENDOSI

- Miratimin e dorheqjes se Kryetarit te Keshillit Mbikqyres Z. Erjon Vesho per arsye te emerimit te tij si Drejtor i pergjithshem i UK sh.a Pogradec.

ASAMBLEJA E AKSIONEREVE

Per Bashkine Pogradec **Per Komunen Bucimas**

Antar i Asamblese **Antar i Asamblese**
Artan Shkembi **Robert Cekici**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ASAMBLEJA E AKSIONAREVE
DREJTORIA E UJESJELLES KANALIZIME SH.A POGRADEC

VENDIM

"Miratimi i Statutit te UK sh.a Pogradec"

NR. 5 DATE 29.05.2013

Asambleja e Aksionareve te UK sh.a Pogradec e mbledhur sot me date 29.05.2013 ora 11:00 ne godinen administrative te UK sh.a Pogradec ne zbatim te ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008, "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" referuar kerkeses Nr.134/1Prot. date 27.05.2013 se drejtorit te pergjithshem per mbledhje te Asamblese se Aksionareve.

VENDOSI

- Miratimin me unanimitet te Statutit te UK sh.a Pogradec (Statuti bashkelidhur)

ASAMBLEJA E AKSIONEREVE

Per Bashkine Pogradec **Per Komunen Bucimas**

Antar i Asamblese **Antar i Asamblese**
Artan Shkembi **Robert Cekici**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ASAMBLEJA E AKSIONAREVE
DREJTORIA E UJESJELLES KANALIZIME SH.A POGRADEC

VENDIM

"Miratimi i antarit te ri te Keshillit mbikqyres"

NR. 7 DATE 29.05.2013

Asambleja e Aksionareve te UK sh.a Pogradec e mbledhur sot me date 29.05.2013 ora 11:00 ne godinen administrative te UK sh.a Pogradec ne zbatim te ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008, "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" referuar kerkeses Nr.134/1Prot. date 27.05.2013 se drejtorit te pergjithshem per mbledhje te Asamblese se Aksionareve si dhe referuar Vendimit Nr. 6 date 29.05.2013 per Miratimin e dorheqjes se Z. Erjon Vesho nga Keshilli Mbikqyres i UK sh.a Pogradec

VENDOSI

- Miratimin e antarit te ri te Keshillit Mbikqyres Z. ARJAN MEMA.

ASAMBLEJA E AKSIONEREVE

Per Bashkine Pogradec **Per Komunen Bucimas**

Antar i Asamblese **Antar i Asamblese**
Artan Shkembi **Robert Cekici**

4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
POGRADEC

AUTORIZIM

PER PERFAQESUESIN E KESHILLIT TE BASHKISE POGRADEC NE ASAMBLENE E AKSIONEREVE TE U.K. sh.a. DHE TE DREJTAT E PERFAQESIMIT

Dhene me Vendimin e Keshillit te Bashkise
Nr. 35, date 28 / 05 / 2013

Ne zbatim te Ligjit nr. 9901 date 14/04/2008, "Per shoqerite tregetare" neni 140 dhe te Vendimit te Keshillit te Bashkise Pogradec me **nr.35, date 28/05/2013**, Keshilli i Bashkise,

AUTORIZON :

Z. Artan SHKEMBI, te perfaqesoje Keshillin e Bashkise ne mbledhjen e Asamblese te Aksionareve te Shoqerise U.K. sh.a. ku qendrimi i mbajtur do te jete:

1. Per miratimin e doreheqjes se Kryetarit te Keshillit Mbikqyres z. **Erjon Vesho** per arsye te emerimit te tij si drejtor i sh.a Ujesjelles – kanalizime Pogradec dhe konfirmimin e anetarit te ri te keshillit mbikqyres **z. Arjan Mema** . Vendimi te jete **Pro**
2. Per miratimin e shperndarjes se fitimit te vitit 2012. Vendimi te jete**Pro**.

KRYETAR I KËSHILLIT
Eduart KAPRI

HKIA POGRADEC
ERTETOHE NJESIA NE
NR FLETE 1 (një)
Mema

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
POGRADEC

AUTORIZIM

PER EMERIMIN DHE MANDATIMIN E PERFAQESUESIT NE ASAMBLENE E AKSIONAREVE TE U.K. sh.a.

Dhene me Vendimet e Keshillit te Bashkise
Nr. 24, dhe 25, date 21/07/2011

Ne zbatim te Ligjit nr. 9901 date 14/04/2008, "Per shoqerite tregetare" neni 38 dhe te Vendimeve te Keshillit te Bashkise Pogradec me nr. 24, dhe 25, date 21/07/2011, Keshilli i Bashkise,

AUTORIZON :

z. Artan SHKEMBI, te perfaqesoje Keshillin e Bashkise ne mbledhjen e Asamblese te aksionareve te shoqerise U.K. sh.a. ku qendrimi i mbajtur do te jete:

1. Futjen ne rendin e dites dhe votimin per:
    - Shkarkimi nga detyra te 4 anetareve te Keshillit Mbikqyres ne UK.sh.a. te propozuar me Vendim te Keshillit te Bashkise nr. 7, date 16/02/2011.
    - Emerimi i Z. **Thoma Angjellari, Inxhinier** anetar i keshillit Mbikqyres i UK.sh.a.
    - Emerimi i Z. **Erjon Vesho, Jurist**, anetar i keshillit Mbikqyres te UK.sh.a.
    - Emerimi i Z. **Petro Stefani, Ekonomist**, anetar i keshillit Mbikqyres te UK.sh.a.
    - Emerimi i Znj. **Mimoza Shuli, Ekonomiste**, anetare e keshillit Mbikqyres i UK.sh.a.
    - Emerimi i Z. **Arjan Mema, Ekonomist**, anetar i keshillit Mbikqyres i UK.sh.a. ne rast se ne zbatim te statutit te ri, Bashkia Pogradec do te kete te drejten e perfaqesimit ne Keshillin Mbikqyres me 5 anetare.
2. Te autorizohet miratimi i Statutit te shoqerise aksionere U.K. sh.a. pas ndryshimeve ne perputhje me ligjin dhe konsultimeve me perfaqesuesin e aksionerit te Komunes Bucimas.
3. Per pikat e tjera te rendit te dites perfaqesuesi mund te votoje sipas gjykimit te tij.

KRYETAR
Eduart KAPRI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I KOMUNËS BUÇIMAS
POGRADEC

KESHILLI I KOMUNES BUCIMAS
Date 24/05/2013

" MANDAT PERFAQESIMI "

Keshilli I Komunes Bucimas, me propozim te Kryetarit te Komunes, mbeshtetur ne Ligjin Nr.8652, date 31/07/2000 " Mbi organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore" , ne V.K.M Nr. 660, date 12/09/2007 " Per transferimin e aksioneve te shoqerive te ujesjelles kanalizime tek njesite e qeverisjes vendore", V.K.M Nr.677, date 03/10/2007 " Per disa shtesa ne V.K.M Nr.642, date 11/10/2005 'Per keshillat mbikqyres te shoqerive shteterore' ", V.K.M Nr.678, date 03/10/2007 " Per disa shtesa tek V.K.M Nr.271 , date 09/05/1998 ' Per miratimin e statutit tip te shoqerive anonime shteterore' ", ne Udhezimin e Ministrise se Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes Nr.965, date 11/12/2007 " Per zbatimin e V.K.M per transferimin e aksioneve te shoqerive anonime ujesjelles kanalizime tek njesite e qeverisjes vendore":

VENDOSI :

1- TE MANDATOJE SI PERFAQESUES TE AKSIONERIT TE KESHILLIT TE KOMUNES BUCIMAS NE MBLEDHJEN E RADHES TE KESHILLIT MBIKQYRES, DHE TE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE AKSIONEREVE TE UJESJELLES KANALIZIME POGRADEC Z. ROBERT RAMADAN CEKICI ME DETYRE NEN/KRYETAR I KOMUNES BUCIMAS.
2- Z. ROBERT CEKICI KA TE DREJTE TE PERFAQESOJE ME TE DREJTA TE PLOTA AKSIONERIN KESHILLI I KOMUNES BUCIMAS.
3- CDO QENDRIM I SHPREHUR NGA PERSONI I MESIPERM PERFAQESON QENDRIMIN DHE VULLNETIN E KESHILLIT TE KOMUNES BUCIMAS.
4- Z. ROBERT CEKICI KA TE DREJTE TE VOTOJE SIPAS GJYKIMIT TE TIJ NE MBLEDHJEN E RADHES PER CESHTJET QE SHQYRTOHEN, DHE KESHILLI I KOMUNES BUCIMAS DO TE JETE DAKORT ME QENDRIMIN DHE VOTEN E TIJ.

KRYETARI I KESHILLIT

EDUART KUQO

Ujësjellës-Kanalizime
Pogradec Sh.A.

Adresa: Lagja 2, Pogradec, Albania
tel ++355 83 226 68
++355 868 20 231
fax ++355 868 20 234
ukpogradec@hotmail.com

POGRADEC ME 29/05/2013

STATUTI SHOQERISE AKSIONARE "UJESJELLES KANALIZIME POGRADEC SH.A"

Ne kete statut:

- "Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare";
- "Statuti" eshte statuti i shoqerise;
- "aksionare" jane personat emrat e te cileve jane regjistruar ne regjistrin e aksioneve te shoqerise si zoterues te aksioneve;
- "Dite te Plota" ne lidhje me periudhen e nje njoftimi eshte periudha qe nuk e perfshin diten kur eshte dhene ose kur konsiderohet se eshte dhene njoftimi dhe diten per te cilen eshte dhene ose hyn ne fuqi njoftimi.

Neni 1
Emertimi

Shoqeria emertohet **"UJESJELLES KANALIZIME POGRADEC SH.A"**. Emertimi i miratuar i shoqerise eshte: **"UJESJELLES KANALIZIME POGRADEC SH.A"**. Emertimi i shoqerise mund te shkruhet me shkronja te medha ose te vogla.

Neni 2
Selia

Selia e shoqerise eshte ne POGRADEC Lagja 2, Ujesjellesi Pogradec. Shoqeria mund te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin brenda Shqiperise ashtu dhe jashte saj.

Neni 3
Deget dhe zyrat e perfaqesimit

Shoqeria, sipas parashikimeve te ketij statuti dhe legjislacioni ne fuqi, mund te hape si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj, qendra dhe perfaqesi apo filiale, dege dhe shoqeri te tjera.

Neni 4
Kohezgjatja

Kohezgjatja e kompanise eshte pa afat te caktuar. Ky afat mund te ndryshohet nje ose me shume here, me vendim te asamblese se aksionereve.

Neni 5
Objekti

Objekti i shoqerise eshte:

1. Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij;
2. Mirembajtja e sistemit(eve) te furnizimit me uje te pijshem;
3. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve;
4. Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujrave te ndotura dhe shitja e tij;
5. Mirembajtja e sistemeve te ujerave te ndotura, si dhe te impianteve te pastrimit te tyre. Shoqeria mundet te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregtar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Shoqeria do te kryeje çdo veprim me qellim marrjen e lejeve, autorizimeve, liçencave dhe miratimeve te nevojshme per realizimin e veprimtarive te saj, per te cilat kerkohen keto dokumente administrative.

Neni 6
Kapitali

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 574.400.000,00 leke me vlere nominate 1.000,00 (nje mije) leke secili. Kapitali i shoqerise eshte derdhur dhe nenshkruar teresisht.

Neni 7
Aksionet

1. Aksionet jane te formes nominative dhe lirisht te transferueshme sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
2. Shoqerite aksionere mbajne nje regjister te posaçem ku regjistrohen te dhenat e zoteruesve te aksioneve te shoqerise. Pronesia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre ne emer te titullarit apo titullareve ne librin e aksioneve te mbajtura nga ana e shoqerise apo ndermjetesve financiare.
3. Pjesmarrja e aksionereve ne kapitalin e shoqerise eshte si vijon:

Aksioneri	Perqindja	Kontributet
• BASHKIA POGRADEC	71.10 %	(408.398,40)
• KOMUNA BUCIMAS	28.90 %	(166.001,60)

Neni 9
Organet e Shoqerise

Organet e Shoqeise aksionare jane :

- Asambleja e Pergjitheshme
- Keshilli mbikeqyres
- Administratori/administratoret

Neni 10
Kerkesa per te paguar aksionet dhe terheqja e aksioneve te papaguara

(1) Administratoret mund t'u kerkojne aksionareve pagimin e kontributeve te pashlyera ne lidhje me aksionet e tyre dhe cdo aksionar (pas marrjes se njoftimit prej 14 Ditesh te Plota ne te cilin percaktohet koha dhe vendi i kryerjes se pageses) i paguan shoqerise shumen e kerkuar per aksionet e zoteruara. Njoftimi per pagese mund te parashikoje shlyerjen me keste te kontributeve te papaguara. Personi te cilit i drejtohet njoftimi per pagesen e kontributit do te jete pergjegjes per njoftimet qe i drejtohen atij pavaresisht kalimit te mepasshem te pronesise se aksioneve me te cilat lidhet njoftimi per pagese.

(2) Zoteruesit e perbashket te nje aksioni do te jene pergjegjes bashkerisht dhe ne menyre solidare per shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit te mesiperm.

(3) Ne rast se pas njoftimit per shlyerjen e kontributeve pagesa perkatese nuk kryhet brenda afatit te parashikuar, personi pergjegjes per shlyerjen e kontributeve do te paguaje nje interes mbi shumen e papaguar me nje kamatevonese prej 4% ne vit duke filluar nga dita e parashikuar per pagesen.

(4) Ne rast se pas njoftimit per shlyerjen e kontributeve, pagesa perkatese nuk kryhet brenda afatit te parashikuar, Administratoret mund te njoftojne paraprakisht te pakten tridhjete Dite te Plota personin pergjegjes per shlyerjen e kontributeve, duke i kerkuar pagesen e shumes se pashlyer se bashku me shumat e mundshme shtese te kamatevoneses. Njoftimi do te permbaje vendin ku duhet te kryhet pagesa dhe deklarimin se ne rast se moszbatimi te tij, pasojat ligjore do te jene ato te parashikuara ne piken 2 dhe 3 te nenit 124 te Ligjit.

(5) Nese pagesa nuk kryhet brenda afatit te parashikuar ne piken 3 te nenit 124, aksioni me te cilin lidhet njoftimi mund te anulohet me vendim te Administratoreve dhe anulimi do te perfshije te gjithe dividendet ose shumat e tjera te pagueshme ne lidhje me aksionet e anuluara dhe te papaguara deri ne momentin e anulimit.

(6) Anulimi i aksionit sjell zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise, ne perputhje me parashikimin e nenit 186 te Ligjit.

(7) Personi, aksionet e te cilit jane anuluar, humbet cilesine e aksionarit lidhur me keto aksione por do te jete pergjegjes ndaj Shoqerise per te gjitha kontributet qe do te shlyheshin nga ky aksionar ndaj shoqerise ne daten e anulimit te aksioneve se bashku me kamatevonesen e llogaritur per keto kontribute perpara anulimit te aksioneve.

Neni 11
Kalimi me Kontrate i Aksioneve

(1) Kontrata e kalimit te aksionit behet me shkrim dhe sipas formaliteteve te percaktuara nga Administratori pergjegjes per mbajtjen e regjistrit te aksioneve te Shoqerise dhe do te zbatohet nga dhe per llogari te personit qe kalon aksionet ose nga personi i autorizuar prej tij dhe nga e per llogari te personit te cilit i kalohen aksionet ose nga personi i autorizuar prej tij, nepermjet regjistrimit ne regjistrin e aksioneve te shoqerise ne perputhje me nenin 119 te Ligjit.

Neni 12
Asambleja e aksionereve

Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratoret, te pakten dy here ne vit. Keshilli Mbikqyres mund te therrase Asamblene e Pergjithshme ne rastet e parashikuara ne nenin 136 te Ligjit. Administratoret therresin menjehere Asamblene e Pergjithshme ne rast se kerkohet nga aksionaret e percaktuar sipas pikes 1 te nenit 139 te Ligjit.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi te derguar me poste ose poste elektronike *(email)* drejtuar cdo aksionari, perfshire edhe perfaqesuesin e aksioneve ne zoterim te perbashket. Njoftimi duhet te kryhet te pakten 21 (njezet e nje) Dite te Plota perpara dates se caktuar per mbledhjen.

Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme jane te pavlefshme ne rast moskryerje te paqellimshme se njoftimit apo mos-marrjes se njoftimit te mbledhjes nga personat te cilet kane te drejte te marrin kete njoftim, me perjashtim te rastit kur shoqeria provon se personi i ka dhene shoqerise nje adrese te pasakte.

Neni 13
Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme

(1) Asambleja e Pergjithshme merr vendime te vlefshme vetem me arritjen e kuorumit te parashikuar nga neni 144 i Ligjit. Aksionaret ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen *(conference call),* audio ose audio-video, ne perputhje me nenin 142 te Ligjit. Aksionaret qe marrin pjese me mjete komunikimi elektronik kane te drejte te votojne nepermjet numrit PIN qe iu eshte derguar se bashku me njoftimin per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.

(2) Keshilli Mbikeqyres cakton Kryetarin e Keshillit Mbikqyres si Kryetar te mbledhjes si edhe nje person per te mbajtur procesverbalin e mbledhjes.

(3) Nese Kryetari i Keshillit Mbikqyres nuk deshiron te caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nese ai nuk eshte i pranishem per pesembedhjete minuta duke filluar nga ora e caktuar per fillimin e mbledhjes, aksionaret e pranishem dhe me te drejte vote zgjedhin njerin prej tyre si Kryetari te mbledhjes.

(4) Administratori ose anetari i Keshillit Mbikeqyres, pavaresisht se nuk eshte aksionar, ka te drejten e pjesemarrjes si edhe te marre fjalen ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme dhe ne mbledhjet e vecanta te aksionareve, zoterues te aksioneve te klasave te ndryshme.

(5) Kryetari, me pelqimin e Asamblese se Pergjithshme te mbledhur ne pajtim me kuorumin e caktuar nga Ligji, mund (dhe eshte i detyruar nese kerkohet nga Asambleja e Pergjithshme), te shtyje mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, por ne mbledhjen e e dyte mund te diskutohen vetem ato ceshtje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht nese nuk do te ishte shtyre mbledhja e meparshme. Kur mbledhja e Asamblese se Pergjithshme shtyhet te pakten katermbedhjete dite, njoftimi do te kryhet te pakten shtate Dite te Plota perpara kesaj date dhe ne te do te percaktohet ora dhe vendi i mbledhjes se shtyre dhe pershkrimi i pergjithshem i rendit te dites. Ne rast te kundert, dhenia e njoftimit nuk eshte e nevojshme.

(6) Asambleja vendos me votim te hapur me perjashtim te rastit kur perpara ose gjate deklarimit te rezultatit, nuk kerkohet ne menyren e duhur nje votim i fshehte. Votimi i fshehte mund te kerkohet nga:

1. Kryetari; ose
2. aksionaret qe perfaqesojne te pakten pese per qind te kapitalit themeltar te Shoqerise. Kerkesa e bere nga nje perfaqesues i autorizuar i aksionarit ka te njejten vlere me kerkesen e paraqitur nga vete aksionari.

(7) Me perjashtim te kundershtimit te nje aksionari, deklarimi i Kryetarit se vendimi eshte marre ne menyre unanime, ose me nje shumice te caktuar, nuk eshte miratuar ose nuk eshte miratuar me nje shumice te caktuar dhe regjistrimi perkates ne procesverbalin e mbledhjes, perben prove perfundimtare te ketij fakti, pa pasur nevoje per numerimin e votave te regjistruara pro ose kunder vendimit.

(8) Ne rast se ka kundershtime per kete deklarate, do te zhvillohet nje votim i fshehte ne lidhje me percaktimin e numrit te votave pro dhe kunder vendimit.

Neni 14
Kryetari dhe sekretari i Asamblese se Aksionereve

Asambleja e aksionereve drejtohet nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres apo ne mungese te tij nga nje person i autorizuar nga kryetari.

Kryetari i asamblese asistohet nga nje sekretar i emeruar nga asambleja e kasionereve.

Proçesverbali i çeshtjeve te shqyrtuara ne mbledhjen e asamblese tregon daten dhe vendin e mbledhjes, menyren e thirrjes, rendin e dites, emrat e drejtuesit dhe sekretarit te asamblese, kuorumi i arritur dhe numrin e aksioneve me te cilat eshte votuar, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara ne mbledhjen e asamblese, nje permbledhje te diskutimeve, tekstin e vendimeve te kaluara per votim dhe rezultatin e votimit. Proçesverbali firmoset nga kryetari dhe sekretari i asamblese dhe duhet noterizuar nga nje noter i pranishem ne mbledhjen e asamblese.

Neni 15
Thirrja e asamblese se aksionereve

Ne rast se te gjitha aksionet jane nominative apo ne rast se shoqeria ka aksioner te vetem, perveç botimeve te parashikuara ne paragrafin e mesiperm duhet te dergohet dhe nje njoftim i derguar me leter rekomande ne adresen e çdo aksioneri me shpenzimet e shoqerise.

Njoftimi, qe duhet te bjere ne doren e aksionereve apo te njihet prej tyre te pakten 21 dite perpara mbledhjes se asamblese, percakton diten, oren dhe vendin ku behet mbledhja, natyren e mbledhjes, te zakonshme apo te jashtezakonshme dhe rendin e dites. Ne rast nevoje, ai tregon vendin ku duhet te depozitohen aksionet per pruresin ose çertifikata e depozitimit te ketyre aksioneve, per te lejuar te drejten e pjesmarrjes ne asamble dhe afatin e fundit te depozitimit.

Cdo mbledhje asambleje qe thirret ne menyre te parregullt duhet te anullohet.

Megjithate, kur te gjithe aksioneret jane prezent apo te perfaqesuar ligjerisht, veprimi i anullimit pranohet.

Legjislacioni i referimit per menyren dhe formen e njoftimit te aksionereve dhe te zhvillimit te mbledhjes se asamblese eshte ligji shqiptar per shoqerite tregtare.

Neni 16
Votat e Pjesemarresve

(1) Ne perputhje me te drejtat ose kufizimet qe rrjedhin nga aksionet, cdo aksion i jep aksionarit te pranishem apo perfaqesuesit te tij te autorizuar ose aksionarit i cili eshte i pranishem permes perfaqesuesit ligjor apo perfaqesuesit te autorizuar ne menyre te rregullt, te drejten e nje vote.

(2) Asnje aksionar nuk voton ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme apo ne mbledhjet e vecanta te zoteruesve te aksioneve te klasave te ndryshme, personalisht ose nepermjet perfaqesuesve, ne lidhje me aksionet e zoteruara prej tij, nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet qe kane te bejne me keto aksione.

(3) Cdo kundershtim ne kohe per cilesine e nje votuesi do ti komunikohet Kryetarit, vendimi i te cilit do te jete perfundimtar. Te gjitha votat e pakundershtuara ne nje mbledhje ose mbledhje te shtyre do te jene te vlefshme.

Neni 17
Emerimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres

(1) Keshilli Mbikqyres do te perbehet prej minimalisht prej 6 anetaresh. Prej te cileve 4 jane propozuar nga Bashkia Pogradec dhe 2 jane propozuar nga Komuna Bucimas. Emerimet do te jene individuale dhe ne perputhje me vendimin e mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te marre me shumice votash, i cili, nese miratohet, sjell emerimin e personit te propozuar si anetar te Keshillit Mbikeqyres. Anetaret e Keshillit Mbikeqyres mund te shkarkohen nga detyra ne cdo kohe nga Asambleja e Pergjithshme, pa cenuar te drejtat qe burojne nga nje kontrate pune e lidhur me Shoqerine.

(2) Nuk mund te zgjidhen ne cilesine e anetarit te Keshillit Mbikeqyres, Administratoret e Shoqerise dhe te shoqerive te te njejtit grup apo personat e lidhur me ta ne perputhje me parashikimet e pikes 3 te nenit 13 te Ligjit. Kufizimet e tjera per emerimin e anetareve te Keshillit Mbikeqyres parashikohen ne nenin 156 te Ligjit.

(3) Shumica e anetareve te Keshillit Mbikeqyres duhet te jene te pavarur sipas parashikimeve te pikave 1 dhe 4 te nenit 155 te Ligjit.

(4) Keshilli Mbikeqyres mund te emeroje nje person i cili deshiron te ushtroje detyren e anetarit te Keshillit Mbikeqyres per te plotesuar nje vend te lire ose si nje anetar tjeter shtese, me kusht qe te mos tejkalohet numri i anetareve te percaktuar ne piken 1 te ketij neni. Kohezgjatja ne detyre e anetarit te emeruar ne kete menyre eshte deri ne mbledhjen vjetore vijuese te Asamblese se Pergjithshme.

Neni 18
Kohezgjatja e mandatit te Keshillit Mbikqyres

1. Kohezgjatja e mandatit te Keshillit Mbikqyres eshte 3 vjet. Ata mund te rizgjidhen pa kufizim.
2. Antaret e Keshillit Mbikqyres jane persona fizike:
   Ata duhet:
   - Te kene te pakten eksperience jo me pak se 5 vjet ne dege te njejta ose te peraferta me objektin e veprimtarise se shoqerise;
   - Te jene me profesion inxhinier, ekonomist, jurist dhe mundesisht me formim pasuniversitar;

Neni 19
Skualifikimi dhe largimi i anetareve te Keshillit Mbikeqyres

(1) Detyra e anetarit te Keshillit Mbikeqyres perfundon ne rast se:

1. personi pushon se qeni anetar i Keshillit Mbikeqyres ne baze te dispozitave te Ligjit duke perfshire parashikimet e pikes 4 te nenit 167 dhe nenit 157.
2. personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese;
3. personi vuan ose mund te vuaje nga crregullime mendore;
4. personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine, ose
5. ka munguar per me shume se gjashte muaj radhazi pa lejen e anetareve te tjere te Keshillit Mbikeqyres ne mbledhjet e ketij keshilli te mbajtura gjate kesaj periudhe dhe Asambleja e Pergjithshme, me propozim te Keshillit Mbikeqyres, vendos ta shkarkoje nga detyra.

Neni 20
Kufizimi i mandateve

Asnje antar i Keshillit Mbikqyres nuk mund te beje pjese ne me shume se 2 (dy) Keshilla Mbikqyres te shoqerive anonime qe kane seli ne territorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 21
Kryetari dhe zevendes kryetari i Keshillit Mbikqyres

1. Keshilli Mbikqyres zgjedh ndermjet antareve te tij nje kryetar dhe nje zevendes kryetar, te cilet therrasin mbledhjen e Keshillit Mbikqyres dhe drejtojne diskutimet. Ata emerohen per te gjithe kohen e mandatit te tyre ne Keshillin Mbikqyres dhe mund te jene te rizgjedhshem.
2. Keshilli Mbikqyres mund te emeroje nje sekretar jashte antareve te tij dhe i cakton ketij dhe pagen.
3. Ne rast mungese ose pengimi te kryetarit, mbledhjet e Keshillit Mbikqyres drejtohen nga zevendes kryetari.

Neni 22
Mbledhjet e Keshillit Mbikeqyres

(1) Mbledhjet e Keshillit Mbikeqyres do te mbahen te pakten dy here ne vit sipas nevojave te aktivitetit tregtar te Shoqerise, derisa Asambleja e Pergjithshme te vendose me shumice te zakonshme votash mbi shpeshtesine e ketyre mbledhjeve.

(2) Vendimet e Keshillit Mbikeqyres merren me kuorumin e percaktuar ne piken 5 te nenit 167 dhe nenin 162 te Ligjit. Anetaret e Keshillit Mbikeqyres mund te marrin pjese ne mbledhje nepermjet mjeteve elektronike te komunikimit perfshire komunikimin video dhe audio konference. Ata mund te marrin pjese ne votime duke perdorur numrin PIN te leshuar cdo anetari ne momentin e emerimit.

(3) Anetaret e Keshillit Mbikeqyres emerojne njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes, i cili mund te shkarkohet ne cdo kohe nga kjo detyre. Kryetari do te drejtoje cdo takim te Keshillit Mbikeqyres ne te cilin ai eshte i pranishem. Ne rast se Kryetari nuk deshiron te drejtoje mbledhjen apo nuk eshte i pranishem brenda pese minutave nga orari i caktuar per mbledhjen, anetaret e Keshillit Mbikeqyres mund te emerojne njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes.

(4) Ceshtjet e rendit te dites vendosen me shumicen e votave te pjesemarresve. Ne rast numri te barabarte votash, vota e Kryetarit do te jete vendimtare.

(5) Te gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Keshillit Mbikeqyres, ose komitetet e anetareve te Keshillit Mbikeqyres, ose nga persona te cilet veprojne si anetare te Keshillit Mbikeqyres, pavaresisht nese behet e ditur ne vijim se emerimi i anetarit te Keshillit Mbikeqyres ka pasur mangesi ose keta anetare jane skualifikuar nga mbajtja e kesaj detyre, ose nuk kishin te drejte te votonin, do te konsiderohen te vlefshme njelloj sikur keta persona te ishin emeruar rregullisht dhe te ishin cilesuar e te vazhdonin detyren si anetare te Keshillit Mbikeqyres dhe te kishin te drejte te votonin ne mbledhje.

(6) Vendimi me shkrim i nenshkruar nga te gjithe anetaret e Keshillit Mbikeqyres te cilet kane te drejte te njoftohen per mbledhjet e Keshillit Mbikeqyres ose te nje komiteti te Keshillit Mbikeqyres eshte njelloj i vlefshem dhe i efektshem sikur te ishte miratuar ne mbledhjen e Keshillit Mbikeqyres ose te komitetit te Keshillit Mbikeqyres, te mbledhur dhe te zhvilluar rregullisht.

Neni 23
Kufizime per votimin e anetareve te Keshillit Mbikeqyres

(1) Anetaret e Keshillit Mbikeqyres nuk do te lidhin marreveshje ose votojne ne mbledhjen e Keshillit Mbikeqyres ose te komitetit se Keshillit Mbikeqyres mbi ceshtje per te cilat keta anetare kane, direkt ose indirekt, nje interes apo detyrim i cili eshte material, qe eshte ose qe mund te jete ne kundershtim me interesat e Shoqerise, ne pajtim me nenin 13 te Ligjit, deri ne momentin kur ne mbledhjen e Keshillit Mbikeqyres, te gjithe anetaret kane rene dakord qe:

1. te autorizojne lidhjen e kesaj marreveshje dhe
2. te autorizojne kete anetar qe te votoje ne lidhje me kete ceshtje.

Autorizimi mund te jete i pergjithshem ose i posacem per nje ceshtje te caktuar. Zbatohet parashikimi i pikave 2 dhe 5 te nenit 13 te Ligjit.

(2) Vota e anetarit te Keshillit Mbikeqyres nuk do te llogaritet ne kuorumin e pjesemarresve ne mbledhje ne lidhje me vendimin per te cilin ky anetar nuk gezon te drejten e votes.

(3) Ne rast se ne mbledhjen e Keshillit Mbikeqyres diskutohet nje ceshtje e lidhur me te drejten e votes se nje anetari te tij, ceshtja mund ti drejtohet Kryetarit te mbledhjes, perpara perfundimit te mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me cdo anetar te Keshillit Mbikeqyres te ndryshem nga ai vete do te jete perfundimtar.

Neni 24
Kompetencat e Keshillit Mbikqyres

Kompetencat e Keshillit Mbikeqyres dhe te Komiteteve se tij

- Keshilli Mbikeqyres nuk merr pjese ne administrimin e Shoqerise. Keshilli Mbikeqyres vezhgon dhe mbikeqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratoret dhe kontrollon pajtueshmerine me kerkesat e Ligjit dhe te Statutit. Detyrat e Keshillit Mbikeqyres te percaktuara nga pika 1 e nenit 167, shkronjat "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "f", "g" e "i" te pikes 1 dhe pika 2 e nenit 154 te Ligjit nuk mund t'iu delegohen Administratoreve.
- Keshilli Mbikeqyres mund t'ia delegoje kompetencat e veta nje komiteti qe perbehet nga nje ose me shume anetare te Keshillit Mbikeqyres. Ky delegim mund te behet ne perputhje me kushtet qe mund te vendosen nga Keshilli Mbikeqyres e mund te revokohet ose ndryshohet. Keshilli Mbikeqyres nuk mund te delegoje asnje nga detyrat te cilat i ngarkohen ne pajtim me dispozitat ligjore.
- Keshilli Mbikqyres emeron dhe shkarkon Administratorin e shoqerise me 5 vota te antareve te tij.
- Asnje ndryshim i Statutit dhe udhezim i Asamblese se Pergjithshme nuk mund te beje te pavlefshme veprimet e meparshme te Keshillit Mbikeqyres te cilat do te kishin qene te vlefshme nese nuk do te ishte bere ndryshimi apo nese nuk do te ishte dhene udhezimi.

Neni 25
Shperblimi i Antareve te Keshillit Mbikqyres

Shperblimi antareve te Keshillit Mbikqyres do te caktohet nga asambleja e Aksionereve, sipas dispozitave perkatese ligjore apo nenligjore dhe mbulohet nga shoqeria.

Shoqeria njeh gjithashtu dhe shpenzimet e bera nga antare te Keshillit Mbikqyres, kur keta te fundit dergohen me sherbim nga vete Keshilli Mbikqyres per probleme te kompanise.

Neni 26
Emerimi i Administratorit

(1) Keshilli Mbikeqyres zgjedh nje ose me shume persona fizike si Administratore te Shoqerise per nje periudhe trevjecare, ne pajtim me piken 2 te nenit 135, piken 2 te nenit 167 dhe nenin 158 te Ligjit. Emerimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te Keshillit Mbikeqyres sipas pikes 4 te nenit 27 te Statutit, i cili, nese miratohet, sjell emerimin e personit te propozuar si Administrator te Shoqerise. Keshilli Mbikeqyres mund te shkarkoje ne cdo kohe Administratoret nga detyra, pa cenuar te drejtat qe burojne nga nje kontrate pune e lidhur me shoqerine.

(2) Anetaret e Keshillit Mbikeqyres nuk mund te caktohen si Administratore. Kufizime te tjera lidhur me emerimin e Administratoreve parashikohen ne piken 2 te nenit 158 te Ligjit.

Neni 27
Kompetencat e Administratoreve

(1) Politikat tregtare te Shoqerise do te administrohen dhe Shoqeria do te perfaqesohet nga Administratoret te cilet mund te ushtrojne te gjitha kompetencat e tyre ne perputhje me parashikimet e pikes 2 te nenit 167, shkronjave "a", "gj", "h" dhe "i" te pikes 1 te nenit 154, dhe pikave 3 dhe 5 te nenit 158 te Ligjit. Detyrat e Keshillit Mbikeqyres, ne perputhje me parashikimet e pikes 1 te nenit 167 dhe shkronjave "b", "c", "9", "d", "dh", "e", "e", "f", "g" dhe "i" te pikes 1 te nenit 154 te Ligjit nuk mund t'iu delegohen Administratoreve.

(2) Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Pergjithshme dhe te udhezimeve te Keshillit Mbikeqyres nuk do te shfuqizojne akte te meparshme te Administratoreve, te cilat do te ishin te vlefshme nese ndryshimi nuk do te ishte kryer ose udhezimi nuk do te ishte dhene.

Neni 28
Shkarkimi i Administratoreve

(1) Detyra e Administratorit perfundon ne rast se:

1. personi nuk eshte me Administrator ne baze te dispozitave te Ligjit perfshire shkarkimin nga Keshilli Mbikeqyres ne pajtim me piken 2 te nenit 167, dhe shkronjen "c" te pikes 2 te nenit 135 te Ligjit;
2. personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese;
3. personi vuan ose mund te vuaje nga crregullime mendore;
4. personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine, ose
5. ka munguar per me shume se gjashte muaj radhazi pa lejen e Keshillit Mbikeqyres ne mbledhjet e Administratori te mbajtura gjate kesaj periudhe dhe Keshilli Mbikeqyres vendos ta shkarkoje nga detyra.

Neni 29
Kufizimet e Administratorit

(1) Administratori nuk do te lidhi marreveshje per ceshtje ne te cilin keta kane, direkt ose indirekt,nje interes apo detyrim i cili eshte material, ne kundershtim ose mund te jete ne kundershtim me interesat e Shoqerise, ne pajtim me nenin 13 te Ligjit, deri ne momentin kur ne mbledhjen e Keshillit Mbikeqyres, te gjithe anetaret kane rene dakord qe:

1. te autorizojne lidhjen e kesaj marreveshje dhe
2. te autorizojne kete anetar qe te votoje ne lidhje me kete ceshtje.

Autorizimi mund te jete i pergjithshem ose i posacem per nje ceshtje te caktuar. Zbatohet parashikimi i pikes 2 dhe 5 te nenit 13 te Ligjit.

Neni 30
Emerimi i eksperteve kontabel te autorizuar

(1) Me propozim te Keshillit Mbikeqyres, Asambleja e Pergjithshme cakton nje ose me shume persona fizike ose nje shoqeri ekspertesh kontabel te autorizuar si eksperte kontabel te autorizuar te shoqerise per tre vjet me radhe, ne pajtim me shkronjen "9", pika 2 e nenit 135 te Ligjit. Emerimi behet nepermjet nje vendimi te Asamblese se Pergjithshme te marre me shumice te zakonshme, i cili nese miratohet, sjell emerimin e personit te propozuar si ekspert kontabel te autorizuar te Shoqerise.

(2) Gjate mandatit te tyre, ekspertet kontabel te autorizuar mund te largohen nga detyra vetem per shkaqe te arsyeshme. Mendimet e ndryshme per metodat e kontabilitetit apo procedurat e kontrollit nuk perbejne shkaqe te arsyeshme per largimin eksperteve kontabel te autorizuar.

(3) Eksperti Kontabel i Autorizuar ose shoqeria e Eksperteve Kontabel te Autorizuar i raporton Keshillit Mbikeqyres ne perputhje me piken 3 te nenit 20 te ketij Statuti, per ceshtjet kryesore qe rezultojne nga kontrolli financiar dhe, ne vecanti, per dobesi te kontrollit te brendshem ne lidhje me procesin e raportimit financiar.

(4) Personat e mposhtem emerohen si Ekspert Kontabel i Regjistruar.

Z.Bashkim Killo Me Lic.130 dhe NIPT K33708614R.

Znj. Etleva Ashiku me Lic. 177 dhe NIPT K83903002N

Neni 31
Ushtrimi Financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti.

Neni 32
Dividentet

(1) Ne perputhje me dispozitat e Ligjit, shoqeria me shumice te zakonshme te votave se Asamblese se Pergjithshme mund te deklaroje dividendet ne perputhje me te drejtat perkatese te aksionareve.

(2) Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe lidhen me aksionet, te gjithe dividendet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumat e paguara per aksionet per te cilet paguhet dividendi. Te gjithe dividendet pjesetohen dhe paguhen ne perpjesetim te drejte me shumat e paguara per aksionet, pjeses ose pjeseve te periudhes per te cilen paguhet dividendi; ne rast se aksioni emetohet me kushtin e perfitimit te dividendit nga nje date e caktuar, dividendi do te paguhet ne perputhje me kete kusht.

(3) Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqerise nese nje gje e tille nuk parashikohet ne te drejtat e aksionit.

(4) £do dividend qe nuk eshte kerkuar te paguhet brenda dymbedhjete vjeteve nga data e maturimit, ne rast se vendoset nga Asambleja e Pergjithshme, do te perfitohet nga shoqeria e cila nuk do te jete me e detyruar qe ta paguaje ate.

Neni 33
Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

Administratoret, pas vendimit te marre nga Asambleja e Pergjithshme me shumice te kualifikuar votash sipas kuorumit te percaktuar nga neni 145 i Ligjit, mund te vendose te kaloje ne kapitalin themeltar te Shoqerise fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te paguar dividende preferenciale apo shuma te tjera te parashikuara per rezerva ligjore ose kapitali.

Neni 34
Inventari dhe Llogaritjet vjetore

1. Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat ligjore.
2. Ne mbledhjen e ushtrimit financiar, Administratori harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar.
3. Administratori pergatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar.

Neni 35
Prishja dhe likuidimi

Ne rast te likuidimit te Shoqerise, likuiduesi, ne perputhje me Ligjin dhe me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjithshme te marre me shumice te kualifikuar, mund te shperndaje ne dobi te aksionareve te gjithe ose nje pjese te vleres se pasurive te Shoqerise dhe per kete qellim, mund te vleresoje cdo pasuri dhe te percaktoje menyren e shperndarjes midis aksionareve ose atyre qe zoterojne aksione te klasave te ndryshme te Shoqerise.

Neni 36
Dispozita te Pergjithshme

Per çfare nuk eshte shprehur ne kete statut, referimi behet te dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, te zbatueshem per tregtaret dhe shoqerite tregtare ne çdo kohe.

AKSIONERET

Per Bashkine Pogradec	Per Komunen Bucimas
Perfaqesuesi Z. Artan Shkembi	Perfaqesuesi Z. Robert Cekici

POGRADEC ME 29/05/2013

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Adresa: Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

Nr. 1 Prot. **Pogradec më 09/02/2016**

VENDIM
I ASAMBLESE SE PERGJITHESHME TE AKSIONEREVE

Nr. 01, date 09.02.2016

Ne Pogradec, sot me date 09.02.2016 une Eduart Kapri me cilesine e Aksionerit te vetem te Shoqerise "***Ujesjelles Kanalizime Pogradec***" **sha** dhe regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe paisur me numur identifikimi Nipt J64103615J duke u mbeshtetur ne VKM nr 63 date 27.01.2016 "Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e firnizimit me uje te pijshem, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura" si dhe ne ligjin nr 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" neni 114 pika 2, dhe neni 117 pika 1 germa (d) " dhe neni 26 e vijues te ligjit9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit":

VENDOSI

1- Depozitimin e statutit te ri te shoqerise"***Ujesjelles Kanalizime Pogradec***" **sha i plotesuar ne baze te satutit tip te miratuar sipas lidhjes nr 1 te VKM nr 63 date 27.01.2016 "Per riorganizimin e opartaoreve qe ofrojne sherbimin e firnizimit me uje te pijshem, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura".**

2- Ky vendim regjistrohet ne librin e vendimeve te Asamblese dhe te behen ndryshimet ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Biznesit.

Aksioneri i Vetem
"***Ujesjelles Kanalizime Pogradec***" **sha**

Eduart KAPRI
KRYETAR

STATUTI
I SHOQËRISË AKSIONARE Ujesjelles-Kanalizime Pogradec

Neni 1
Emërtimi dhe selia

1. Shoqëria aksionare ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të bashkisë Pogradec aksionare e saj.
2. Shoqëria e krijuar në këtë mënyrë emërohet Ujësjellës-Kanalizime Pogradec.
3. Selia e shoqërisë është në adresën Korce, Pogradec, POGRADEC Lagja 2, Ujesjellesi Pogradec.

Neni 2
Objekti

1. Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkisë së krijuar sipas ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", është:
   - a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
   - b) Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
   - c)Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
   - ç) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
   - d) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.
2. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
3. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, licencat sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3
Kapitali

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 574.400.000.00 lekë. Kapitali i shoqërisë është nënshkruar tërësisht.
2. Kontributet e aksionarit janë kontribute në natyrë, të cilat janë vlerësuar përpara regjistrimit të shoqërisë nga një ekspert i caktuar nga gjykata kompetente, vlerësim i cili është materializuar në një raport vlerësimi që përm-ban një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë.

Neni 4
Aksionet e shoqërisë

1. Aksionet janë të formës nominative dhe pronësia mbi to është e patjetërsueshme, me përjashtim të rasteve kur e drejta e pronësisë i kalon një organi të qeverisjes vendore.
2. Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë.
3. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga një kuotë me vlerë 574.400.000.00 lekë dhe zotërohet në masën 100 % nga aksionari.

Neni 5
Organet e shoqërisë

1. Organet e shoqërisë së ujësjellës-kanalizimeve sh.a., janë:
a) Asambleja e Përgjithshme;
b) Këshilli i Administrimit.

Neni 6
Asambleja e Përgjithshme (AP)

1. Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet nga kryetari i bashkisë përkatëse, i cili merr vendime brenda kompetencave të parashikuara nga ligji për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.
2. Nëse shoqëria aksionare mbulon me shërbim më shumë se një bashki, Asambleja përbëhet nga kryetarët e bashkive përkatëse. Pesha e votës e secilit prej anëtarëve të Asamblesë është në përpjesëtim me përqindjen e aksioneve, sipas ndarjes territoriale-administrative.
3. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në selinë e shoqërisë. Ajo thirret nga kryetari i AP-së, Këshilli i Administrimit, administratori i shoqërisë. Ajo mund të thirret, gjithashtu, nga:
   - a) eksperti kontabël i autorizuar;
   - b) nga një mandatmbajtës, i caktuar nga gjykata, me kërkesën e çdo personi të autorizuar për një rast urgjent;
   - c) me kërkesë të aksionarit të vetëm të shoqërisë.
4. Asambleja e Përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar.
5. Thirrja e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme bëhet nëpërmjet lajmërimit që botohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore dhe që i dërgohet me anë të një njoftimi me letër rekomande çdo anëtari të Asamblesë së Përgjithshme me shpenzimet e shoqërisë.
6. Në njoftimin, që duhet t'i shkojë çdo anëtari të Asamblesë së Përgjithshme apo të njihet prej çdo anëtari, të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së saj, përcaktohen dita, ora dhe vendi ku bëhet mbledhja, natyra e mbledhjes dhe rendi i ditës.
7. Çdo vendim i marrë nga Asambleja e Përgjithshme që thirret në mënyrë të parregullt është absolutisht i pavlefshëm. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas procedurës së kësaj dispozite, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë anëtarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht nga parregullsia.

Neni 7
Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:
   - a) Përcakton politikat tregtare të shoqërisë, si dhe miraton planin e biznesit të hartuar nga Këshilli i Administrimit të shoqërisë, i cili duhet të përputhet me kontratën për menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë e kanalizimeve dhe treguesit të punës, për të cilët është rënë dakord midis palëve kontraktore;
   - b) Miraton pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;
   - c) Miraton projektplanin tarifor që propozohet për miratim në Entin Rregullator të Ujit;
   - ç) Emëron dhe shkarkon ekspertët kontabël të autorizuar;
   - d) Vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
   - dh) Çdo kompetencë tjetër që parashikohet të ushtrojë Asambleja e Përgjithshme në ligjin nr. 9901, dt. 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe në statut.
2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit të Administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Neni 8
Kryetari dhe sekretari i Asamblesë së Përgjithshme

1. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga kryetari i bashkisë përkatëse. Në rast se AP-ja përbëhet nga më shumë se një aksionar, aksionarët zgjedhin kryetarin e AP-së.
2. Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme asistohet nga një sekretar i emëruar nga AP-ja, i cili është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve, si dhe për detyrat e tjera asistuese që i ngarkon kryetari i AP-së.
3. Në procesverbalin e çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e AP-së jepen data dhe vendi i mbledhjes, mënyra e thirrjes, rendi i ditës, emrat e drejtuesit e të sekretarit të AP-së, kuorumi i arritur dhe numri i aksioneve me të cilat është votuar, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e AP-së, një përmbledhje e diskutimeve, teksti i vendimeve të kaluara për votim dhe rezultati i votimit. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit e AP-së në mbledhje, si dhe nga sekretari.

Neni 9
Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme

1. Rendi i ditës i mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme përcaktohet nga personi i cili bën lajmërimin.
2. Në rast se mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme nuk realizohet, rendi i ditës i mbledhjes së saj nuk mund të ndryshohet në lajmërimin për mbledhjen e dytë.

Neni 10
Kuorumi dhe marrja e vendimeve

1. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
   - a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
   - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
   - c) Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit;
   - ç) Investimet;
   - d) Riorganizimin e shoqërisë.
2. Në rastin kur AP-ja ka më shumë se një aksionar, në rastin e çështjeve që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm në mbledhje më shumë se 30% e anëtarëve të saj, me kusht që pjesë e saj të jetë dhe kryetari i Asamblesë së Përgjithshme, me përjashtim të rastit kur AP-ja vendos për shkarkimin e administratorëve e të anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ku nuk kërkohet ky kuorum.
3. Kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar, sipas pikës 4, të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm në mbledhje më shumë se 50% e anëtarëve të saj, me kusht që pjesë e saj të jetë dhe kryetari i Asamblesë së Përgjithshme.
4. Asambleja e Përgjithshme merr vendim me 3/4 (tre të katërtat) e votave të anëtarëve që marrin pjesë në votim, sipas parashikimeve të pikës 3, të këtij neni, lidhur me:
   - a) Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
   - b) Riorganizimin e shoqërisë.
5. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në ligj dhe në pikën 4, të këtij neni, çdo vendim tjetër i Asamblesë së Përgjithshme merret me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në votim, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni.

Neni 11
Këshilli i Administrimit (KA)

1. Këshilli i Administrimit është organi i vetëm që ushtron funksione administrimi dhe mbikëqyrjeje të veprimtarisë së shoqërisë.
2. Kohëzgjatja e funksionit të Këshillit të Administrimit është 3 vjet. Mandati i KA-së ndërpritet në rast konstatimi të mospërmbushjes së objektivave të vendosur në kontratën e performancës midis AP-së dhe anëtarëve të KA-së, sipas legjislacionit në fuqi. Nëse një ose disa vende të anëtarëve të Këshillit të Administrimit mbeten vakant, për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqjeje, zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e mbetjes vakant të vendit. Anëtari i Këshillit të Administrimit i emëruar në zëvendësim të një anëtari tjetër përfundon mandatin e paraardhësit.
3. Anëtarët e Këshillit të Administrimit nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se 1 (një) Këshill Administrimi të shoqërive aksionare që e kanë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
4. Këshilli i Administrimit zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata ushtrojnë këtë funksion për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe janë të rizgjedhshëm. Këshilli i Administrimit mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij dhe i cakton atij dhe pagën, sipas legjislacionit në fuqi
5. Në rast mungese të kryetarit, mbledhjet e Këshillit të Administrimit drejtohen nga zëvendëskryetari.

Neni 12
Përbërja e Këshillit të Administrimit

1. Anëtarët e Këshillit Administrimit janë persona fizikë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një mandat 3-vjeçar dhe mund të rizgjidhen. Ata duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
- Të jenë me profesion inxhinierë të fushës, ekonomist ose jurist.
- Të kenë të paktën eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fusha të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këtë nen është absolutisht i pavlefshëm.

3. Këshilli Administrimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, 1 (një) prej të cilëve është administratori dhe 2 (dy) janë persona të cilët nuk janë të punësuar në shoqëri.
4. Anëtarët e Këshillit të Administrimit në momentin e emërimit lidhin me shoqërinë një kontratë pune, në të cilën janë parashikuar, ndër të tjera, kritere të qarta performance që pritet të arrijë anëtari i Këshillit të Administrimit në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indikatorët) e vendosur në këtë kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshëm dhe në përputhje me biznesplanet e shoqërisë.
5. Në rastin e vendeve vakante, që krijohen me vdekjen apo dorëheqjen e një apo disa anëtarëve të Këshillit të Administrimit, kur numri i anëtarëve të këtij këshilli ka zbritur nën minimumin ligjor, administratorët duhet të thërrasin urgjentisht mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për të plotësuar numrin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit.

Neni 13
Kompetencat e Këshillit të Administrimit

1. Këshilli i Administrimit ushtron, njëkohësisht, funksione administrimi e mbikëqyrjeje të veprimtarisë së shoqërisë dhe i jep administratorit autorizimin për kryerjen e veprimeve që nuk mund të kryhen prej tij pa autorizimin e Këshillit të Administrimit.
2. Këshilli i Administrimit ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrolle që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.
3. Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:
a) Të japë direktiva për administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
b) Të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;
c) Të gjykojë paraprakisht biznesplanin e shoqërisë, të paraqitur nga administratori. Ky dokument duhet të miratohet e të nënshkruhet nga të gjithë e anëtarët e Këshillit të Administrimit për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
ç) Të përgatitë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
d) Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
dh) Të respektojë standardet e kontabilitetit;
e) Të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
ë) Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit të Administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
f) Të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur, dhe raporti i auditimit, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit të Administratorëve. Raporti i Këshillit të Administrimit, përmendur në shkronjën "ë" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
g) Të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
gj) Të miratojë paraprakisht biznesplanin e paraqitur nga administratori dhe t'ia paraqesë për miratim përfundimtar Asamblesë së Përgjithshme.
4. Këshilli i Administrimit ka të drejtë t'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme:
   - a) Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë;
   - b) Treguesit e performancës që duhet të arrijë shoqëria në fund të vitit fiskal, si element bazë i vlerësimit të punës së administratorëve të shoqërisë;
   - c) Kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar, si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
   - ç) Marrjen e huave afatmesme e afatgjata;
   - d) Për çdo çështje tjetër që në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 14
Mbledhja dhe vendimet e Këshillit të Administrimit

1. Këshilli i Administrimit mblidhet jo më pak se një herë në muaj muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë aksionare, me thirrjen e kryetarit.
2. Kryetari duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit të Administrimit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur administratori ose 2 (dy) prej anëtarëve të Këshillit të Administrimit i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.
3. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët kërkues mund të thërrasin Këshillin e Administrimit duke i përcaktuar rendin e ditës.
4. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet me shkrim jo më vonë se 3 (tre) ditë përpara mbledhjes dhe dërgohet me postë ose në rrugë elektronike.
5. Çdo thirrje për mbledhjen e Këshillit të Administrimit duhet të përmbajë çështjet kryesore të rendit të ditës. Mbledhja e Këshillit të Administrimit zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrjen e bërë për këtë qëllim.
6. Këshilli i Administrimit mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në atë mbledhje.
7. Vendimet e Këshillit të Administrimit pasqyrohen në procesverbalet e mbajtura gjatë mbledhjes nga sekretari i Këshillit të Administrimit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Vendimet e Këshillit të Administrimit duhet të nënshkruhen nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. Kopjet e këtyre procesverbaleve vërtetohen nga kryetari dhe sekretari.

Neni 15
Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë KA-në ose një anëtar të saj, duke vërtetuar mospërmbushjen e objektivave të vendosur në kontratën midis palëve, me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 16
Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Mandati i anëtarëve të Këshillit të Administrimit përfundon në rastet e mëposhtme:
a) Me mbarimin e mandatit të administratorit.
b) Me konstatimin e atyre rrethanave të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tyre.

Neni 17
Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit

1. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme, sipas dispozitave përkatëse ligjore apo nënligjore dhe mbulohet nga shoqëria.
2. Shoqëria njeh, gjithashtu, dhe shpenzimet e bëra nga anëtarë të Këshillit të Administrimit, kur këta të fundit dërgohen me shërbim nga vetë Këshilli i Administrimit për probleme të shoqërisë.

Neni 18
Administratori i shoqërisë

1. Administratori i shoqërisë është person fizik, i cili zgjidhet si i tillë për shkak të funksionit në shoqëri, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Ai kryen administrimin e përditshëm të shoqërisë. Për t'u zgjedhur administrator, personi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Master shkencor", në shkencat inxhinierike, ekonomike, juridike apo në fushën e administrimit të biznesit, sipas profilit që do të emërohet.
b) Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve e të trajtimit të ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij, nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe i certifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij.
c) Të ketë eksperiencë pune si drejtues apo administrator në sektorin publik apo privat, si dhe rezultate pozitive të punës, të vërtetuar me referenca nga punëdhënësit e mëparshëm.
3. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me dispozitën e mësipërme është absolutisht i pavlefshëm.
4. Një person nuk mund të emërohet administrator në më shumë se një shoqëri.
5. Administratori emërohet për një periudhë kohe prej 3 (tre) vjetësh, por në bazë kontratash të rinovueshme vjetore. Rinovimi i kontratave midis Asamblesë dhe administratorit do të jetë vjetor në bazë vlerësimesh pozitive të performancës së punës. Numri i mandateve është i pakufizuar.
6. Paga e administratorit caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në aktin e emërimit të tij. Asambleja e Përgjithshme propozon shtim të pagës apo shpërblime për administratorin sipas kritereve të performancës në kontratën e punës së lidhur ndërmjet tij dhe administratorit.
7. Administratori Ekzekutiv ka këto kompe-tenca:
a) Menaxhon dhe është përgjegjës për aktivitetin e shoqërisë nëpërmjet zbatimit të politikave e të planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
b) Harton planbizneset e shoqërisë dhe i paraqet në Këshillin Administrimit.
c) Harton strukturën e organizimit dhe rregulloren e brendshme të veprimtarisë së shoqërisë e cila miratohet nga Këshilli i Admini-strimit. Struktura e organizimit të shoqërisë duhet të ketë patjetër një drejtori/departament teknik dhe një drejtori/departament tregtar, drejtuesit e të cilave zgjidhen nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas neneve 19 dhe 20, të këtij statuti.
ç) I paraqet Këshillit të Administrimit një raport një herë në muaj për ecurinë e shoqërisë. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, administratori duhet t'i paraqesë Këshillit të Administrimit llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli.
d) Përfaqëson dhe vepron në emër të shoqërisë në marrëdhëniet me palë të treta dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së saj.
dh) Paraqet çdo vit përpara Asamblesë së Përgjithshme raportin e veprimtarisë së shoqërisë.
e) Raporton përpara Këshillit të Administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.
ë) Lidh kontrata në emër të shoqërisë pas dhënies së mendimit edhe të dy drejtorëve të tjerë.
f) Siguron bashkëpunimin me institucionet publike dhe personat juridikë vendas apo të huaj në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë.
g) Nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshëm të detyrueshëm për menaxhimin administrativ e financiar të shoqërisë.
gj) Organizon e bashkërendon punën ndërmjet sektorëve në përbërje funksionale të shoqërisë.
h) Krijon një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë.
i) Kryen regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe ligjeve të tjera në fuqi.
j) I paraqet propozime dhe sugjerime Këshillit të Administrimit, në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë, sa herë që i kërkohet ose me nismën e vet.
k) Siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Administrimit.
l) Drejton veprimtarinë e shoqërisë, zgjedh dhe mbikëqyr personelin e saj, përfshirë punësimin, administrimin, kualifikimin e personelit dhe masat disiplinore, në përputhje me ligjin, statutin e shoqërisë dhe rregullat e miratuara nga Këshilli i Administrimit.

Neni 19
Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit teknik

1. Drejtori teknik zgjidhet nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas kritereve minimale:
a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Master shkencor", në shkencat inxhinierike, në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike apo disiplina të ngjashme,
b) Të ketë përvojë pune jo më pak se 3 vjet.
Në rastet kur operatori ushtron veprimtari për përpunimin e ujërave për konsum publik apo për përpunimin e ujërave të ndotura, duhet të ketë edhe një drejtues të dytë teknik, të kualifikuar me diplomë universitare në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike apo disiplina të ngjashme.
c) Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe certifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij.
2. Drejtori teknik ka këto kompetenca:
a) Bën studimin dhe hartimin e projekteve të nevojshme për furnizimin me ujë të konsumatorëve të veçantë ose zonave të banuara.
b) Bën përditësimin e rrjetit të furnizimit me ujë e të kanalizimeve të ujërave të ndotura.
c) Është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe kontrollin e rrjetit shpërndarës.
ç) Administron dhe mirëmban gjithë rrjetin e tubacioneve, kolektorët kryesorë, pusetat e shkarkimit të ujërave të ndotura dhe pajisjet që shërbejnë për largimin e ujërave të ndotura që vijnë kryesisht nga banesat (ujëra të ndotura dhe industriale).
d) Është përgjegjës për sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm sasior dhe cilësor në zonën e shërbimit sipas standardeve në fuqi dhe garantimin e një sistemi teknikisht të përshtatshëm për furnizimin me ujë që nga burimet deri te konsu-matori.
dh) Garanton largimin efikas të ujërave të ndotura me anë të një sistemi të përshtatshëm të rrjetit të kanalizimeve dhe trajtimin e tij në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.
e) Çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës me Drejtorin e Përgjithshëm

Neni 20
Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit tregtar

1. Drejtori tregtar zgjidhet nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas kritereve minimale:
a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Master shkencor", në shkencat ekonomike, në degët financë/administrim biznesi.
b) Të zotërojë certifikata përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë.
2. Drejtori tregtar ka këto kompetenca:
a) Siguron mbarëvajtjen dhe zbatimin e procedurave ligjore për të gjithë veprimtarinë ekonomike-financiare të shoqërisë.
b) Siguron zbatimin e praktikave e të procedurave ligjore dhe nënligjore të cilat mbrojnë asetet e shoqërisë dhe administron burimet financiare të saj.
c) Harton planbuxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv.
ç) Është përgjegjës dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara, si dhe raportin e administrimit, dokumente të cilat ia paraqet për miratim paraprak administratorit ekzekutiv. Administratori ekzekutiv i paraqet Këshillit të Administrimit për miratim të gjitha pasqyrat financiare vjetore, raportin e administrimit, si dhe propozimet për caktimin e fitimit.
d) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.
dh) Ushtron kontrolle periodike mbi veprimtarinë ekonomike-financiare të ndjekur nga specialistët përkatës.
e) Garanton ruajtjen e standardeve të kontrollit të brendshëm financiar dhe zbatimin e standardeve të kontrollit financiar të specifikuara nga Ministria e Financave.
ë) Siguron zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë.
f) Siguron zbatimin e sistemit financiar dhe të faturim/arkëtimit të shoqërisë.
g) Çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës me drejtorin e Përgjithshëm.

Neni 21
Detyrimi i besnikërisë

1: Përveç sa parashikohet në dispozitat e këtij statuti, administratorët detyrohen:
a) Të kryejë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë;
b) Të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve, të përcaktuara në këto dispozita;
c) Të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat merret vendim;
ç) Të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme, të interesave personale me ato të shoqërisë;
d) Të ushtrojnë detyrat e tyre me profesio-nalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e shoqërisë tregtare.
3. Administratorët, që veprojnë në kundër-shtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 e 2, të këtij neni, janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Neni 22
Shkarkimi i administratorit

1. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin me shumicë të thjeshtë votash në rast të konstatimit të mospërmbushjes së objektivave të kontratës midis palëve.
2. Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë shkarkimin e administratorit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga një institucion shtetëror për shkarkimin e tij, si rezultat i një detyrimi ligjor/zyrtar.

Neni 23
Përfundimi i mandatit të administratorit

Mandati i administratorit të shoqërisë përfundon me konstatimin e atyre rrethanave të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tij.

Neni 24
Ekspertët kontabël të autorizuar

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme dhe kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Neni 25
Ushtrimi kontabël

Ushtrimi kontabël fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 26
Inventari - llogaritë vjetore

1. Mbajtja e kontabilitetit dhe paraqitja e pasqyrave financiare vjetore bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar.
2. Në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, shoqëria i harton pasqyrat financiare vjetore në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar.
3. Administratori përgatit, në datën e pasqyrave financiare, raportin e administrimit për gjendjen dhe performancën e shoqërisë gjatë ushtrimit kontabël.

Neni 27
Rezultati i ushtrimit dhe përcaktimi i fitimit

1. Fitimi i tatueshëm përcaktohet sipas dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.
2. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
3. Fitimet e akumuluara nga shoqëria, pas arritjes së rezervës 10 për qind, vlera e të cilave e kalon nevojën për investime dhe zhvillimin e shoqërisë, do t'i kalojnë dhe do të përdoren nga Bashkia. Fitimet e akumuluara brenda këtij kufiri do të përdoren nga shoqëria sipas nevojave të saj për investime kapitale.

Neni 28
Procedura e bashkimit të shoqërisë me operatorë të tjerë

Shoqëria aksionare mund të bashkohet me operatorë të tjerë vetëm në rastet kur nga ana e shoqërive të plotësohen kushtet e mëposhtme:
a) Të jetë të licencuar nga Enti Rregullator i Ujit.
b) Të ketë vlerësuar dhe përditësuar inventarin e aseteve e të likuiditeteve të tyre.
c) Të jetë miratuar me vendim përkatës të Këshillit Bashkiak.

Neni 29
Likuidimi i shoqërisë

Likuidimi i shoqërisë të bëhet sipas mënyrës dhe formës të përcaktuar me ligj.

Neni 30
Dispozita të kalimtare

Për sa nuk është parashikuar në statut, rregullimi i modaliteteve të tjera që lidhen me funksionimin e shoqërisë të bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

PËRFAQËSUESI i ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

KRYETARI I BASHKISË POGRADEC

Eduart KAPRI

Eduart Kapri